



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 2638

NR. VENDIMI 3427



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANE

NR.2638

AKTI

NR 3427 VENDIMI

Dt

rregjistrimi

02.09.2016

Dt 24.04.2017

VENDIM
NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, e perbere nga :

ANTONELA PRENDI – GJYQTARE

asistuar nga sekretare gjyqesore Dila Doci, sot me 24.04.2017 mori ne shqyrtim ne séance gjyqesore publike ceshtjen civile me nr 2638 Akti, qe i perket :

PADITES:

Shoqeria ***, me qender ne ***, me administrator zj. ***, perfaqesuar nga av. ***, *** sipas autorizimit dt 05.09.2016 dhe z. *** ne baze te autorizimit dt 20.09.2016,

TE PADITUR:

Shoqeria ***, me qender ne ***, me administrator zj.Suela Hyseni, perfaqesuar nga av. *** dhe z. *** sipas autorizimit

dt 03.10.2016.

Drejtoria e Pergjithshme e Markave dhe Patentave, me qender ne Tirane, Bulevardi “ Gjergj Fishta”, nr 10, kati V, perfaqesuar nga juristja *** ne baze te autorizimit nr *** Prot,dt 04.10.2016 (**ne mungese ne shpallje**).

OBJEKTI: Shfuqizimi i markes “ *** “ (fjale dhe figure) me nr rregjistrimi *** e **, dt 22.05.2013 per shkak se ky rregjistrim cenon te drejten e pronesise industriale te markave te meparshme *** (fjale, fjale dhe figure) te cilat jane te mirenjohura, me pasoje njoftimin e DPPM per vendimin per shfuqizim marke dhe rregjistrimin e vendimit ne rregjistrin e markave. Detyrimin e te paditurit *** te ndaloje perdorimin e markes tregetare *** (fjale, fjale dhe figure) ne pronesi te paditesit nga te gjitha produktet ushqimore te perfshira ne klasen 30 te klasifikimit te Nices duke perfshire ndalimin e importimit, shperndarjes, tregetimit dhe fushatave publicitare (duke perfshire ate ne internet) dhe te materialeve te tjera promovuese si dhe reklamimin e produkteve ushqimore nen marken *** nr **, me **, dt 22.05.2013 qe ne figure permban fjalen *** me pronesi te paditesit dhe mosperseritjen e ketyre veprimeve ne te ardhmen. Publikimin e ketij vendimi ne mediat kombetare me shpenzimet e te paditurit.

a) bllokimin fizik,

ambalazheve,

*** qe

me oriz)te

shperndarjes

b) ndalimin e

gjitha llojeve te

emertimin *** (

perfshi pikat

veprimeve prane

*** (fjale

perfundimtar.

Sigurimi i padise duke urdheruar

konfiskimin dhe nxjerrjen jashte qarkullimit te

paketimeve te te gjitha te mallrave oriz

permbajne emertimin *** (te mbushura ose jo

ndodhura ne pikat e prodhimit, magazinimit,

apo shitjes me shumice ose pakice te tyre

hyrjes se ambalazheve, paketimeve te te

mallrave oriz te *** sh.p.k qe pembajne

te mbushura me oriz ose jo) ne rruget tregtare,

doganore te RSH c) pezullimin e te gjitha

rregjistrit te markave te DPPM lidhur me marken

dhe figure)me nr ***, e ***, dt 22.05.2013

deri ne ditën e dhenies se nje vendimi

BAZA LIGJORE : Neni 43/2 (b dhe c), nenet 173, 184(2) te ligjit nr 9947,

638, 839 te

dt 07.07.2008 “ Per pronesine industriale”. Nenet

KC. Nenet 32, 202, 348 te KPrC.

Gjykata pasi administroi provat, degjoi konkluzionet perfundimtare te paleve, ku paditesi *** kerkoi pranimin e kerkesepadise dhe i padituri *** sh.p.k rrezimin e saj dhe si cmoi provat ne teresi

VEREN

Prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane eshte paraqitur per gjykim kerkesepadia me pale ndergjyqese, objekt dhe baze ligjore te sipercituar.

Kjo ceshtje civile rezulton te jete gjykuar me pare nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, e cila me vendimin nr ***, dt *** ka vendosur pranimin e kerkesepadise se shoqerise ***. Gjykata e Apelit Tirane pasi ka shqyrtuar ankimin e paraqitur nga i padituri *** sh.p.k me vendimin nr ***, dt *** ka

vendosur prishjen e vendimit te shkalles se pare dhe kthimin e ceshtjes per rigjykim me tjetër trup gjykues per shkak te konstatimit te shkeljeve te procedurale ne lidhje me formimin e ndergjyqesise, duke lene detyre thirrjen ne cilesine e te paditurit ne proces te Drejtorise se Pergjithshme te Patentave dhe Markave ne kushtet kur crregjistrimi i markes tregetare te rregjistruar nga i padituri *** sh.p.k konceptohet si detyrim ligjor qe rendon ndaj DPPM ne baze te ligjit “ Per pronesine industriale “ (Gjykata e Apelit veren se referuar formulimit te objektit te padise , por dhe dispozitivit te vendimit gjyqesor objekt ankimi, rezulton se kerkimi i pare i pales paditese ka te beje me nje veprim qe praktikisht nuk mund te kryhet prej saj, por duhet te kryhet nga personi i trete ne kete gjykim DPPM.....Gjate rigjykimit te ceshtjes Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane duhet te hetoje dhe te orientoje palet ne percaktimin e sakte te kerkimeve dhe ne percaktimin e sakte te ndergjyqesise- pra ose ne thirrjen e DPPM ne cilesine e te paditurit ose ne rregullimin e objektit te padise. “

Referuar orientimeve te mesiperme te Gjykates se Apelit Tirane paditesi *** gjate rigjykimit te ceshtjes thirri ne cilesine e te paditurit ne gjykim DPPM konform nenit 116/ c te KPrC dhe sakteso i objektin e padise ne baze te nenit 185 te KPrC duke kerkuar perfundimisht sa parashtrohet ne pjesen hyrese te vendimit.

Pas zhvillimit te nje hetimi te plote dhe te gjithanshem te ceshtjes, administrimit te provave dhe debatit te tyre ne perputhje me parimin e kontradiktoritetit rezultoi e provuar se:

Shoqeria *** eshte subjekt i se drejtes tregetare shqiptare, e rregjistruar me dt 10.05.1994, me qender ne Durres dhe objekt veprimtarie ne fushen e prodhimit, tregetimit, importit dhe eksportit te artikujve te ndryshem ushqimore referuar te dhenave te ekstraktit te QKB-se. Ky subjekt tregetar ka rregjistruar ne pronesi te tij prane pales se paditur DPPM, nen emertimin “ ***” markat e meposhtme :

1.marka me nr rregjistrimi ***,” ***”, fjale dhe figure, e depozituar me dt 24.10.2007 dhe e rregjistruar me dt 20.11.2008, ne klasen 30 sipas klasifikimit nderkombetar te Nices, qe i perket listes se mallrave oriz, sheqer, miell, niseshte, miell orizi, krem karamel, ereza;

2.marka me nr rregjistrimi ***, “ ***”, fjale dhe figure, e depozituar me dt 24.10.2007 dhe e rregjistruar me dt 04.11.2008 qe i perket klasave 30 dhe 31 sipas klasifikimit nderkombetar te Nices, ku perfshihen produktet miell, oriz, niseshte, buding, fasule, ereza;

3.marka me nr rregjistrimi ***, “***”, fjale dhe figure, e depozituar me dt 20.04.2015 dhe e rregjistruar me dt 16.01.2017, qe i perket klasave 29 dhe 30 sipas klasifikimit nderkombetar te Nices qe i perket produkteve vajr bimor luledielli, misri, oriz, sheqer, miell niseshte etj.

Aspekti vizual i markave gjen pasqyrim ne dokumentacionin mbi rregjistrimin e tyre te paraqitur ne gjykim nga pala e paditur DPPM.

Pas rregjistrimit te markave te mesiperme tregetare shoqeria *** ka tregetuar produktet ushqimore korresponduese, perfshi ate objekt gjykimi, oriz, per nje periudhe te konsiderueshme kohore duke siguruar pozicionin e saj ne treg dhe nje raport me konsumatorin e saj.

Njekohesisht pala e paditur shoqeria “ ***i “ sh.p.k eshte subjekt i se drejtes tregetare shqiptare, i rregjistruar ne QKB me dt 03.12.2009, me qender ne Shkoder, me objekt veprimtarie krahas te tjerash dhe ne fushen e importit, eksportit dhe tregetimit te produkteve ushqimore. Referuar provave te paraqitura ne gjykim nga DPPM rezulton se ne pronesi te shoqerise ***i sh.p.k eshte rregjistruar marka me emertimin “ ***i”, me nr rregjistrimi ***, e depozituar per rregjistrim me dt 22.05.2013 dhe e rregjistruar me dt 13.02.2014. Marka eshte e llojit fjale dhe figure, ka emertimin ne rregjister “ ***i” dhe permban ne logon e saj emertimin verbal te stilizuar “ *** “. Kjo marke eshte rregjistruar ne listen e mallrave oriz, makarona, sheqer, miell, niseshte, te cilat i perkasin klases 30 sipas klasifikimit nderkombetar te Nices.

Paditesi *** ka inicuar kete gjykim duke parashtruar disa kerkime ndaj te paditurve DPPM dhe shoqerise “ ***i “ sh.p.k si me poshte vijon :

1.Kerkimi mbi shfuqizimin e markes tregetare te rregjistruar ne pronesi te pales se paditur.

Ne baze te nenit 143, paragrafi 2 (b) i ligjit “ Per pronesine industriale” marka nuk mund te rregjistrohet dhe nese eshte rregjistruar duhet te deklarohet e pavlefshme kur eshte e njejte ose e ngjashme me nje marke te meparshme, e cila mbrohet per mallra ose sherbime identike ose te ngjashme dhe per pasoje shkakton konfuzion te konsumatori. Mundesia per konfuzion shkaktohet kur konstatohet ngjashmeri mes shenjave ose ngjashmeri mes mallrave / sherbimeve. Ne rastin objekt gjykimi mallrat e mbuluara nga markat e rregjistruara nga palet ndergjyqese jane identike (oriz) dhe markat objekt gjykimi jane thujse identike, duke shkaktuar konfuzion ne treg, kriter pengues ligjor per rregjistrimin nga DPPM te markes se pales se paditur ne kushtet kur rregjistrimi i markes se paditesit eshte pararendes ne kohe. Njellojshmeria e mallrave te prodhuara nga palet ndergjyqese buron dhe nga fakti se ato perfshihen ne te njejten kategori. Referuar ekstraktit te markave respektive te paditesit dhe pales se paditur, markat objekt konflikti jane rregjistruar ne klasat 30 dhe 31 te Klasifikimit te Nices.

Marka “ ***” apo “ Oriz *** “ pronesi e pales paditese perbejne marka te mirenjohura, ku elementi verbal “ ***” gezon karakter te theksuar dallues. Ky element rezulton i inkorporuar dhe ne marken e kundershtruar te pales se paditur, ne pozicion dominant, i stilizuar, poshte fjale “ oriz”, sikurse marka e paditesit, duke i bere ato ekstremisht te ngjashme. Marka e te paditurit per shkak te prezences se elementit verbal “ ***” i orienton konsumatorin drejt markave te mirenjohura “ *** “ , pronesi e pales paditese dhe per pasoje konfondohen

produktet e tregetuara nga secila pale. I padituri ***i sh.p.k jo vetem tregeton produkte identike nen nje marke qe eshte e ngjashme me markat “ *** “ te pales paditese, por aplikon keto produkte ne ambalazhe qe dukshme jane te njejta me ambalazhet e paditesit, duke shtuar mundesine per konfuzion.

Kriteret vleresuese mbi konfondimin qe shkaktojne markat mes tyre orientohet drejt a) krahasimit vizual, fonetik dhe konceptual mes tyre bazuar ne elementet dallues e dominant dhe ngjashmerive mes ketyre komponenteve. Marka e te paditurit eshte e ngjashme vizualisht dhe fonetikut me marken e paditesit. Elementi verbal “ ***” i stilizuar me ngjyre flori eshte dominues dhe i inkorporuar ne te dyja markat b) kushtet e tregetimit dhe niveli i vemendjes se konsumatorit. Produkti “ oriz” ofrohet per konsumatorin ne pika tregetimi qe nuk sigurojne kushte te optimale per reklamimin e mallrave, duke mos i siguruar blyesve mundesite e mjaftueshme per ti diferencuar produktet nga pikepamja vizuale, cka shkakton konfuzion mes mallrave. Vemendja e konsumatorit ne blyesjen e produkteve ushqimore te perdorimit te gjere dhe me kosto te ulet sikurse rezulton ne rastin e produktit “ oriz”, eshte pergjithesisht e ulet, fakt qe rrit mundesine per konfuzion mes markave te ngjashme ne treg.

Markat “ *** “ , pronesi e pales paditese kane karakter te theksuar dallues duke permbushur funksionin esencial te markes ;identifikimin e origjines tregetare te produktit te tregetuar. Elementi verbal “ *** “ perben elementin dallues te markave te paditesit, ka fituar reputacion te larte ne treg permes reklamimit e perdorimit ne produktet ushqimore dhe identifikues i drejteperdrejte i tyre.

Markat” *** “ konsiderohen marka te mirenjohura ne treg jo vetem se fillesa e perdorimit te tyre eshte e hershme prej vitit 1999, por dhe sasia e konsiderueshme e tregimit te produkteve qe ato identifikojne brenda territorit te RSH.Njokohesisht markat “*** “ pronesi e pales paditese jane reklamuar gjeresisht ne treg, permes mediave vizive, te shkruara dhe on line, duke rritur reputacion dhe njohjen e gjere te tyre nga konsumatorët.

Perdorimi i markes se paditesit nga i padituri demton karakterin dallues te saj, pra dobeson aftesine e markes per te identifikuar mallrat dhe sherbimet per te cilat ajo eshte rregjistruar.

Paditesi legjitimohet ne kerkimin e tij per crregjistrimin e markes se pales se paditur per shkak se eshte pronari i nje marke te meparshme te rregjistruar dhe te mirenjohur ne territorin e RSH. Markat “*** “ te paditesit mbajne date depozitimi 24.10.2007, kurse ajo e te paditurit 22.05.2013. Per kete shkak markat “ *** “ te paditesit *** konsiderohen marka me te drejta te meparshme dhe perdorimi i tyre nga i padituri cenon te drejtat pasurore dhe jopasurore.

Ne baze te ligjit “ Per pronesine industriale” cdo pale e interesuar mund te kundërshtojë jo vetem nje marke ne proces rregjistrimi, por dhe nje marke te rregjistruar brenda tre viteve nga marrja dijëni per shkeljen, sikurse rezulton ne rastin objekt gjykimi dhe per pasoje te kerkoje shfuqizimin e crregjistrimin e saj nga DPPM.

I padituri ka patur dijani te plote mbi rregjistrimin e meparshem te markes “ *** “ nga shoqeria *** dhe per shkak te bashkepunimit tregtare mes tyre, por ne shkelje flagrante te ligjit “ Per pronesine industriale “ ka regjistruar prane DPPM marken e tij, ekstremisht te ngjashme me marken e pales paditese dhe indetifikuese e te njejtin produkt (oriz). I padituri *** sh.p.k eshte njoftuar nga paditesi per shkeljen e te drejtave te tij pasurore dhe jopasurore, madje eshte paditur dhe kallezuar penalisht.

2. Kerkimi mbi ndalimin e perdorimit te markes “ *** “ e regjistruar ne pronesi te pales paditese.

Rregjistrimi dhe perdorimi me pas ne menyre te kundraligjshme i markes nga pala e paditur legjitimon paditesin ne kerkimin gjyqesisht te marrjes se masave qe garantojne ndalimin e perdorimit te markes se kundershuar ne produktet ushqimore te perfshira ne klasen 30 te Klasifikimit te Nices, duke perfshire ndalimin e importimit, shperndarjes dhe tregtimit te produkteve nen marken e kundershuar, materialeve promovuese, fushatave publicitare apo reklamimeve. Sa me siper synohet te ndalohej cdo veprim cenes i interesave pasurore dhe jopasurore te paditesit nga perdorimi ne menyre te kundraligjshme i markes se tij nga pala e paditur. Perdorimi i markes se kundershuar nga i padituri perben konkurrence te pandershme referuar neneve 638 dhe 639 te KC dhe nenit 10 te Konventes se Parisit “Per mbrojtjen e pronesise industriale”, te cilat synojne te mbrojne investimet kreative, intelektuale, ekonomike, te bera nga bizneset per te bere te dallueshme mallrat dhe sherbimet e tyre nga ato te nje tjeter kompanie.

3. Kerkimi mbi marrjen e masave per sigurimin e padise.

Disponimi perfundimtar gjyqesor mbi kerkimet e pales paditese duhet te bashkeshoqerohet dhe me marrjen e masave per sigurimin e padise, specifikisht ato te percaktuara nga ligji “ Per pronesine industriale“, te percaktuara ne objektin e padise, per te parandaluar demtimin e metejshem te interesave pasurore dhe jopasurore te pales paditese deri ne ekzekutimin e ketij vendimi gjyqesor, ne eventualitet te pranimit te kerkesepadise.

Pala e paditur “ *i” sh.p.k ne prapesimet e parashtruara gjate gjykimit kerkoi rrezimin e kerkesepadise duke argumentuar :**

1. marka “ ***i *** “ e regjistruar nga DPPM eshte krejtesisht e ndryshme nga marka “ *** “ dhe “ Oriz *** “ pronesi e pales paditese *** , cka perjashton cdo lloj pretendimi per konfuzion ne treg mes konsumatoreve. Marka “ ***i *** “ paraqitet fjale dhe figure, me shkronja te vogla, me ngjyre te kuqe te bardhe, blu, permaban ne konfiguracion nje anije dhe poshte saj fjalen “ *** “. Ndersa markat e pales paditese paraqiten fjale e figure “ *** “, me germa te medha, me ngjyre blu dhe te verdhe. Fakti qe secila prej markave perfaqeson te njejtin lloj produkti ushqimor (oriz) nuk bie ne kundershim me ligjin “ Per pronesine industriale “ ne kushtet kur ne treg cdo subjekt tregetar mund te tregetoje te njejtin mall permes perdorimit te markes se tij identifikuese

te ndryshme nga subjektet e tjera. Inkorporimi i elementit verbal dhe fonetik “ *** “ ne marken e shoqerise “ ***i “ sh.p.k nuk mund te konsiderohet cenim i markes se paditesit “ *** “ dhe “ Oriz *** “ pasi kjo fjale nuk perben marke ekskluzive te ndonje shoqerie ne RSH. DPPM ka proceduar me rregjistrimin e shume markave, ku rezulton te jete perfshire fjala “ *** “ qe nderkombetarisht nenkupton ngjyren e floririt. Kontrolli i ligjshmerise se markes se shoqerise “ ***i “sh.p.k eshte realizuar nga DPPM gjate procesit te rregjistrimit te saj, sikurse dhe Drejtoria Rajonale e Autoritetit Ushqimor Shkoder, i cili ka miratuar ambalazhimet e produktit “ oriz”, qe kane respektuar nga pikepamja figurative marken e rregjistruar nga pala e paditur. Shoqeria *** realizon shitjen me shumice ne treg te produktit “oriz” dhe nuk mund te vleresoje, sikurse dhe nuk mundi te provoje ne gjykim, konfuzionin e pretenduar ne treg mes radheve te konsumatoreve ne raport me produktet e tregetuara nga secili subjekt. Ne cdo treg mund te dallohen lehte produktet permes ambalazhit te tyre, subjektit tregetar prodhues apo elementeve te tjere diferencues mes markave.

2.shoqeria “ ***i “ sh.p.k ka respektuar te gjitha procedurat ligjore ne lidhje me rregjistrimin e markes te sanksionuara ne ligjin “ Per pronesine industriale”. Aplikimi per rregjistrimin e markes eshte publikuar ne buletin e DPPM. Ne baze te nenit 152 te ligjit “ Per pronesine industriale “ pronari i nje marke te meparshme te rregjistruar ka te drejte te kundershtojte rregjistrimin e markes te publikuar brenda tre muajve nga data e aplikimit, e drejte e cila nuk eshte ushtruar nga shoqeria ***. Ligji “ Per pronesine industriale” sanksionon procedurat e shqyrtimit te kundershimit dhe mundesine e ankimit me pas te vendimit te Bordit te Apelimit te DPPM ne gjykate brenda 30 diteve nga njoftimi i tij. Mosezaurimi i rruges administrative te kundershimit te markes se publikur nenkupton humbjen e se drejtes te paditesit per te kerkuar shfuqizimin e markes ne ruge gjyqesore pas rregjistrimit te saj nga DPPM. Ndjekja e rruges administrative te ankimit perben kusht detyrues dhe paraprak ne raport me kontrollin gjyqesor referuar dhe vendimeve unifikuese te Gjykates se Larte nr 2, dt 06.01.2009 dhe nr 1, dt 26.11.2010.

3.ne baze te nenit 173 te ligjit “ Per pronesine industriale “ shfuqizimi ne ruge gjyqesore i nje marke mund te realizohet vetem ne rast te mosrespektimit te kerkesave te neneve 142 dhe 143 te ketij ligji gjate procedurave te rregjistrimit nga DPPM, fakt qe nuk rezultoi e provuar ne rastin objekt gjykimi. DPPM ka respektuar kuadrin ligjor ne lidhje me rregjistrimin e markes se pales se paditur “ ***i *** “ pas zhvillimit te nje hetimi paraprak administrative.

I padituri Drejtoria e Pergjithshme e Patentave dhe Markave prapesoi :

1.Eshte zhvilluar nje hetim i plote administrative gjate shqyrtimit te aplikimit dhe dokumentacionit shoqerues per rregjistrimin e markes se pales se paditur “ ***i “ sh.p.k. Gjate kesaj procedure nuk ka patur asnje kontestim ne ruge

administrative nga subjekte qe pretendojne cenim te drejtave te meparshme te fituara permes rregjistrimit te markave te tyre. Duke cmuar se marka “ ***i” gezon karakter dallues ne raport me markat e meparshme te rregjistruara nga subjekte te tjere tregtare dhe nuk ekzistojne kushtet penguese ligjore te sanksionuara ne nenet 142 dhe 143 te ligjit “ Per pronesine industriale” DPPM ka proceduar me rregjistrimin e markes se pales se paditur.

Gjykata pasi cmoi ne teresi provat ne analize te kerkimeve e prapesimeve te paleve ndergjyqese dhe ligjit qe disiplinon marredhenien juridike objekt konflikti gjyqesor konkludon ne pranimin e pjesshem te kerkesepadise.

Rezultoi e provuar nga hetimi gjyqesor se ndergjyqesat e ketij gjykimi, shoqeria *** dhe i padituri ***i sh.p.k jane perfshire ne nje konflikt civil ne themel te se cilit qendrojne pretendimet per mbrojtjen ne menyre respektive te drejtave pasurore dhe jopasurore te fituara nga rregjistrimi i markave tregtare qe perfaqesojne produktet e treguara nga secila pale.

Paditesi dhe i padituri jane subjekte qe ushtrojne aktivitet ne fushen e tregtimit te produkteve ushqimore dhe ne funksion te kesaj veprimtarie kane realizuar rregjistrimin prane DPPM te markave qe identifikojne tregtimin e produktit “ Oriz”, ne rend kohor te diferencuar, ku perparesia procedurale prevalon ndaj paditesit ***.

Nga provat e paraqitura ne gjykim nga DPPM evidentohen qartesisht elementet e seciles prej markave dhe produktet qe ato perfaqesojne:

1.marka ***, pronesi e shoqerise ***, me nr rregjistrimi ***, dt 24.10.2007, paraqitet si fjale dhe figure, e stilizuar, me germa te medha, me ngjyre blu dhe te verdhe, e rregjistruar per mallrat e klases 30 te klasifikimit te Nices, ku perfshihet dhe produkti oriz;

2.marka ORIZ ***, ne pronesi te paditesit ***, me nr rregjistrimi ***, dt 24.10.2007, paraqitet si fjale dhe figure, me ngjyre blu dhe te verdhe, me germa te medha,e rregjistruar per mallrat e klases 30 te klasifikimit te Nices, ku perfshihet dhe produkti oriz;

3.marka ***i, pronesi e pales se paditur, me nr rregjistrimi ***, dt 13.02.2014 paraqitet ne formen e fjales dhe figures,ku ne konfiguracion grafik evidentohen me germa te vogla, fjalet “ ***i” dhe “ ***”, kjo e fundit e stilizuar, qe bashkeshoqerojne ne figure nje anije, me ngjyrat blu, e kuqe e bardhe. Edhe kjo marke i perket mallrave te klases 30 te Klasifikimit te Nices.

Paditesi *** pretendon cenimin e te drejtes se markes nga shoqeria ***i sh.p.k, si pasoje e rregjistrimit te markes se pales se paditur ne kundersizim me ligjin “ Per pronesine industriale” dhe ne vijimesi perdorimin e kundraligjshem te saj per tregtimin e produktit oriz, duke cenuar parimet e konkurrences se ndershme. Per kete shkak kerkimet e paditesit *** sh.p.k iniciojne me shfuqizimin e markes se rregjistruar ne shkelje te dispozitave ligjore dhe vijojne me urdherimin e ndalimit te perdorimit te markes nga pala e

paditur, sikurse dhe marrjen e masave te nevojshme per te siguruar ekzekutimin e se drejtes se pretenduar.

Duke vleresuar teresisht te ligjshme proceduren e rregjistrimit te markes, vleresimin e kontrollin paraprak te ushtruar nga DPPM dhe te drejtat e fituara nga rregjistrimi i markes ne perputhje me kuadrin ligjor, te paditurit kontestojne kerkimet e pales paditese, fakt qe orienton analizen gjyqesore drejt dispozitave te ligjit “ Per pronesine industriale “ qe disiplinon marredhenien juridike objekt konflikti gjyqesor :

“Objekti i ketij ligji eshte rregullimi i sistemit te dhenies dhe te mbrojtjes se te drejtave te pronesise industriale.Mbrojtja e pronesise industriale ka si objekt c) markat tregetare dhe te sherbimit” (neni 1);

“1.Cdo shenje ose kombinim shenjash qe paraqitet grafikisht dhe qe sherben per te dalluar markat apo sherbimet e nje personi fizik ose juridik, nga ato te nje personi tjetër fizik apo juridik, eshte marke qe perfaqeson ato mallra ose sherbime, me kusht qe te permbushen kerkesat e neneve 141 ose 143 te ketij ligji.

2.Mund te perbejne marka shenjat e meposhtme a) fjalet, perfshi emrat personale, shkronjat, numrat, shkurtimet b) shenjat figurative, perfshi vizatimet c) format dy ose tre dimensionale, format e mallrave dhe /ose amabalazhimi i tyre c) kombinimet e ngjyrave e dritehijeve si dhe ngjyrat ne vetvete d)kombinimi i shenjave, te permendura ne shkronjat a) deri ne c) te kesaj pike (neni 140).

“1. Nje shenje ka karakter dallues nese nepermjet saj perdoruesi i zakonshem dallon nje numer mallrash ose sherbimesh specifikë, nga nje tjetër numer mallrash ose sherbimesh, te njejta me te parat, lidhur perkatesisht me origjinen tregetare te tyre.

2.Karakter i dallues i nje shenje vleresohet ne lidhje te ngushte me mallrat dhe sherbimet, te cilat shenja ka qellim ti dalloje” (neni 141)

“1.Marka nuk mund te mbrohet nese perdorimi i saj bie ne kundërshtim me te drejtat e meparshme.

2.Marka nuk mund te rregjistrohet dhe nese eshte rregjistruar, ajo duhet te deklarohet e pavlefshme kur :

a) eshte e njejte me nje marke te meparshme dhe mallrat e sherbimet, per te cilat eshte aplikuar ose rregjistruar ajo, jane identike me mallrat ose sherbimet, per te cilat eshte mbrojtur marka e meparshme;

b)eshte e njejte ose e ngjashme me nje marke te meparshme,e cila mbrohet per mallra dhe sherbime identike ose te ngjashme dhe kur, per shkak te njellojshmerise ose te ngjashmerise, ekziston mundesia e shkaktimit te konfuzionit te publiku, ku perfshihet dhe mundesia e bashkelidhjes me marken e meparshme;

5.Marke e meparshme ne kuptim te pikes 2 te ketij neni vleresohet a)marka me nje date aplikimi per rregjistrim me te hershme sesa data e aplikimit per rregjistrim e nje marke tjetër tregetare, duke patur parasysh, kur eshte rasti ,

pretendimin per prioritet per ate marke, sipas nenit 147 te ketij ligji (neni 143)

“ 1.Gjykata me kerkese te personit te interesuar shfuqizon marken e rregjistruar nese a) eshte rregjistruar ne kundershtrim me kerkesat e neneve 142 dhe 143 te ketij ligji ne kohen kur eshte depozituar aplikimi per rregjistrim b)aplikimi per rregjistrimin e markes eshte bere me keqbesim.

2.Cdo marke e rregjistruar qe shfuqizohet vleresohet e pagene duke filluar nga data e depozitimit te markes.” (neni 173)

“ DPPM publikon te dhenat e aplikimit ne buletin e saj nese eshte leshuar deshmia e depozitimit dhe marka eshte ne perputhje me kerkesat e neneve 140, pika 2 e 3 dhe 142 te ketij ligji.. (neni 151)

“ Kundershtimi i nje marke te publikuar depozitohet ne DPPM brenda nje periudhe tre mujore nga data e publikimit kundrejt pageses se tarifes perkatese nga a) aplikanti i nje marke te meparshme te depozituar ne DPPM ose nga pronari i nje marke te meparshme te rregjistruar ne perputhje me parashikimet e pikave 1 dhe 2 te nenit 143 te ketij ligji...

2.Periudha per paraqitjen e kundershtrimit nuk mund te zjatet pertej periudhes se parashikuar ne piken 1 te ketij neni ... (neni 152)

“1.Pronari i markes se rregjistruar gezon te drejten ekskluzive te perdorimit te markes ne perputhje me te drejtat e parashikuara ne kete ligj.

2.Pronari i markes se rregjistruar gezon te drejten te ndaloje personat e trete te perdorin , gjate ushtrimit te veprimtarise se tyre tregetare dhe pa autorizimin e tij : a) nje shenje qe eshte e njejte me marken, per mallra dhe sherbime, qe jane te njejta me te ato per te cilen eshte rregjistruar marka b) nje shenje qe eshte e njejte ose e ngjashme me marken apo qe per shkak te njellojshmerise apo ngjashmerise se mallrave apo sherbimeve, per te cilat perdoret shenja, me mallrat ose sherbimet, qe mbulohen nga marka e rregjistruar, mund te shkaktojne konfuzion te publiku, ku perfshihet dhe mundesia e bashkelidhjes se shenjes me marken tregetare (neni 156)

1.Gjykata me kerkesen e personit te interesuar urdheron vendosjen e masave te perkohshme kur ai :

a) eshte pronar sipas parashikimeve te ketij ligji dhe gezon te drejtat e percaktuara ne nenet 36,127,156 dhe 178 te ketij ligji;

b)depoziton dokumenta qe i japin mundesi gjykates per te vendosur se e drejta e tij eshte shkelur ose ka shume te ngjare qe shkelja te ndodhe;

c) kerkon qe masat te merren pa vonese te pajustificuar pas konstatimit te shkeljes se pretenduar.

2.Me marrjen e masave te perkohshme gjykata :

a) ndalon shkeljet e pritshme ose shkeljet qe kane filluar te kryhen;

b)ndalon hyrjen e mallrave ne rruge tregetare;

c)urdheron ruajtjen e provave te rendesishme per shkeljen e pretenduar me kushte qe te mbrohet informacioni konfidencial. Masa te tilla mund te perfshijne

pershkrimin e hollesishem, me ose pa marrjen e mostrave ose bllokimin fizik te mallrave shkelese dhe sipas rastit te materialeve dhe mjeteve te perdorura per prodhimin dhe /ose shperndarjen e ketyre mallrave dhe dokumentave te lidhura me to;

c)konfiskon, nxjerr jashte qarkullimit ose ve nen kontroll per periudhen gjate procesit gjyqesor, objektet qe perbejne shkelje te drejtave sipas ketij ligji ose mjetet e perdorura kryesisht per prodhimin e ketyre objekteve;

d) urdheron ne rastin e nje shkelje te kryer ne rruge tregtare ne rastin e nje shkelje te kryer ne rruge tregtare dhe nese pala e demtuar demonstron rrethana te tilla, qe mund te rrezikojne riparimin e demeve, bllokimin e perkohshem te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme te shkelesit te pretenduar , perfshi dhe bllokimin e llogarive te tij bankare dhe aseteteve te tjera. Per kete qellim gjykata mund te urdheroje paraqitjen e dokumentave bankare, financiare ose tregtare ose shfrytezimin e mundesive te tjera te pershtatshme per te zoteruar informacionin perkates.

5. Masat e perkohshme te permendura ne pikat a) dhe b) te pikes 2 te ketij neni mund te jepen kunder shkelesit te pretenduar te se drejtes se pronesise industriale si dhe ne kushte te njejta kunder ndermjetesit sherbimet e te cilit jane perdorur nga pala e trete per te cenuar kete te drejte.

*6. Marrja e masave te perkohshme kushtezohet me depozitimin nga paditesi te nje garancie te pershtatshme ose te nje sigurimi tjetër te barazvlefshem me te qe synojne te sigurojne kompensimin e cdo dëmi qe i shkaktohet pales kundërshtare...”(**neni 187**).*

*“ Ne varesi te dispozitave qe kane lidhje me mbrojtjen e shenjave dalluese dhe te drejtave te patentes veprimet e konkurrences se pandershme kryhen nga cilido qe 1. perdor emrat ose shenjat dalluese te cilat mund te sjellin ngaterrese me emrat dhe shenjat dalluese te perdorura ligjerisht nga te tjere ose imiton produktet e nje konkurrenti ose kryhen veprime te cilat mund te sjellin ngaterresa me produktet dhe veprimtarine e nje konkurrenti 3.perdor vete drejteperdrejte ose terthorazi cdo mjet qe nuk perputhet me parimet e ndershmerise profesionale dhe mund te demtoje veprimtarine e tjetrit” (**neni 638 i KC**)*

*“2.Cdo veprim ne kundërshtim me praktikat e ndershme te konkurrences ne industri apo tregeti perben konkurrenca te pandershme. 3.Ne vecanti duhet te ndalohen : i) veprimet e asaj natyre qe krijojne konfuzion te cdo lloji ne industri dhe tregeti me ate te konkurrentit...(**neni 10 i Konventes se Parisit, viti 1889** “ Per mbrojtjen e pronesise industriale).*

Cmohet e nevojshme te nenvizohet paraprakisht se ndonese objekt i kerkimit eshte shfuqizimi i nje marke te rregjistruar ne kundershtim me ligjin nga DPPM mosmarreveshja gjyqesore eshte kompetence lendore e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, ne kushtet kur konflikti mes ndergjyqesave ka natyre tregetare dhe shqyrtimi i tij synon te garantoje ne themel mbrojtjen dhe ndalimin e cenimit te te drejtave te fituara nga rregjistrimi i nje marke tregetare. Ne baze te nenit 348 te KPrC konfliktet qe burojne nga markat tregetare gjykohen nga seksioni i mosmarreveshjeve tregetare te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane (*Mosmarreveshjet qe rrjedhin nga patentat, markat tregetare dhe te sherbimit, dizenjot tregtare, modelet dhe cdo e drejte tjeter qe rrjedh nga pronesia industriale gjykohen nga seksioni i mosmarreveshjeve tregetare ne gjykatën e shkalles se pare Tirane sipas rregullave te parashikuara ne Kod*).

Rregjistrimi i nje marke tregetare duhet te respektoje teresine e rregullave te mirepercaktuara ne ligjin “ Per pronesine industriale” te cilat synojne jo vetem te certifikojne markat qe dallojne dukshem mes tyre produktet dhe sherbimet e ofruara nga subjekte te ndryshme tregetare, por dhe mbrojtjen e te drejtave pasurore dhe jopasurore ne raport me secilen prej markave duke shmangur rregjistrime te markave te njejta apo te ngjashme, per te njejten kategori mallash e sherbimesh apo te ngjashme me to te cilat konfundojne konsumatorin duke mos i mundesuar zgjedhje te qarta ne treg.

Kujdesi ligjor i treguar ne kete drejtim ne mbrojtje dhe te rregullave te konkurrencës se ndershme ne treg materializohet dhe ne nje teresi normash ligjore qe i mundesojne cdo subjekti te cenuar te mbroje marken e rregjistruar prej tij duke kontestuar ne rruge administrative apo gjyqesore cdo rregjistrim te mevonshem te markes se nje tjeter subjekti te kryer ne kundershtim me ligjin.

E drejta e pronarit te cenuar te markes inicon me kundershtimin e markes se publikuar me qellim kontestimin qe ne rruge administrative te procedurave te rregjistrimit te saj prane DPPM. Mosshfrytezimi i ketij mjete ligjor nuk pengon subjektin e cenuar te kundeshoje marken ne rruge gjyqesore pas rregjistrimit te saj, duke kerkuar deklarimin e pavlefshem te markes dhe rregjistrimin nga DPPM. Ky konkluzion buron nga interpretimi i nenit 143 te ligjit “ Per pronesine industriale “ ne te cilin sanksionohet se pronari i nje marke tregetare mund te kundeshoje nje marke dhe pas rregjistrimit te saj nga DPPM per shkaqe relative te sanksionuara ne kete dispozite ligjore. Ne kete kontekst gjykata e cmon te pabazuar prapesimin ne aspektin procedural te shoqerise ***i sh.p.k se pala paditese nuk mund te pretendoje ne rruge gjyqesore shfuqizimin e markes se pales se paditur ne kushtet e moskundershtimit

paraprakisht ne rruge administrative te procedurave te rregjistrimit te markes “ ***i ***”. Kundershtimi i nje marke te publikuar gjate procedurave administrative nuk perben kusht paraprak dhe te detyrueshem per kerkimin gjyqesor te shfuqizimit te kesaj marke pas rregjistrimit te saj. Garancite e ofruara nga ligji per mbrojtjen e te drejtave qe burojne nga nje marke e rregjistruar shtrihen dhe pas rregjistrimit nga DPPM (post rregjistrimit).

Rregjistrimi i nje marke tregetare legjitimon pronarin e saj qe ne kuader te mbrojtjes se te drejtave pasurore dhe jopasurore te fituara, te kundershtojte cdo marke tregetare te mevonshme, e cila ne kushtet e rregjistrimit ne kundershtim me ligjin cenon marken e tij. Kjo e drejte procedurale qe buron nga neni 143 i ligjit “ Per pronesine industriale” imponon hetimin ne rruge gjyqesore te kritereve qe determinojne kundraligjshmerine e rregjistrimit te markes se kundershtuar dhe perdorimin e saj, si me poshte vijon :

1.ngjashmeria apo natyra e njejte e markes se rregjistruar me pare ne raport me marken e kundershtuar.

Ky kriter ligjor ne aspektin procedural dikton paraprakisht ekzistencen e nje diference kohore ne rregjistrimin e markave, qe nenkupton se njera prej markave, ajo qe kerkon mbrojtjen ligjore ne pozicionin e pales paditese, ka fituar me pare mbrojtje ligjore permes rregjistrimit te saj, cka ne ligj perfshihet ne konceptin e “markes se meparshme”.

Markat *** te pales paditese mbajne si data depozitimi 24 tetor 2007, ndersa ajo e te paditurit 23 maj 2013. Ne kete kontekst ne kuptim te nenit 143/5 (a) te ligjit “ Per pronesine industriale“ markat *** konsiderohen marka me nje te drejte te meparshme.

Krahasimi i shenjave qe konceptojne markat respektive bazohet ne ngjashmerite e tyre fonetike, vizuale dhe konceptuale. Krahasimi bazohet ne pershtypjen e pergjithshme qe markat percjellin duke marre ne konsiderate elementet dallues dhe dominant te tyre.

Referuar seciles prej markave respektive te paleve ndergjyqese konstatohet nje ngjashmeri e larte mes tyre ne aspektin vizual dhe fonetik. Elementi verbal dhe vizual “ *** “ te markat e pales paditese rezulton te jete inkorporuar ne marken e pales se paditur. Elementi “ *** “ eshte dominant dhe ka karakter te theksuar dallues ne marken e pales paditese, i vendosur ne qender te saj dhe komponent teresisht identifikues i markes. Eshte pikerisht ky element i huazuar ne marken e pales se paditur, i cili referuar menyres se perdorimit te tij ne shenjen e markes rrit nivelin e ngjashmerise me marken e pales paditese. Elementi verbal *** ne marken e pales se paditur paraqitet i

stilizuar dhe me ngjyre te florinjte sikurse ne marken e paditesit. Ai rezulton i qenderzuar ne marke, duke u bere tipari parasor dallues ne syte e konsumatorit, ndersa elementi i anijes dhe fjala “***i” konceptohen periferike. Eshte pranuar gjeresisht nga praktika gjyqesore qe nje element domunues i nje marke tregetare, i inkorporuar ne nje tjetere marke perben baze te mjaftueshme ne kuptim te ligjit per ngjashmeri te larte mes markave. Ne kete menyre pala e paditur riprodhon verbalisht, me te njejtat ngjyra dhe te njejtat vendndodhje ne paketimin e produktit oriz elementin dominues te markes se pales paditese, “***”.

Ngjashmeria mes markave buron dhe ne aspektin konceptual. Markat e paleve ndergjyqese “***” dhe “***i ***” jo vetem qe kane ngjashmeri ne shqiptimin e tyre, pavaresisht menyres se te shkruarit, por ne aspektin konceptual fjala “***” qe nenkupton “arin” personalizon ne tregun shqiptar produktin e orizit, qe tregetohet ne menyre te njekohshme nga te dyja palet ndergjyqese.

Per keto arsye gjykata konstaton se mes markave te rregjistruara me pare te shoqerise *** sh.p.k, respektivisht *** dhe ORIZ *** dhe markes se pales se paditur ***i *** ekziston nje ngjashmeri e larte vizuale dhe fonetike.

2. njellojshmeria apo ngjashmeria mes produkteve te tregetetuara apo sherbimeve te ofruara nga markat e perfshira ne konflikt.

Funksioni i nje marke tregetare eshte drejteperdrejte i lidhur me garancine qe ajo i ofron konsumatorit ne lidhje me subjektin dhe origjinen e mallit ose sherbimit qe ajo identifikon duke i mundesuar diferencimin nga operatoret e tjere ne treg.

Ne rastin objekt shqyrtimi eshte lehtesisht e konstatueshme qe produktet te cilat identifikohen permes markave te paleve ndergjyqese perfshihen ne te njejtin klase sipas Klasifikimit te Nices (klasa 30, produkte ushqimore oriz, makarona, miell, niseshte etj).

3. shkaktimi i konfuzionit ne treg ne radhet e konsumatoreve ne lidhje me markat tregetare .

Mundesia e konfondimit ne treg e konsumatoreve ne raport me markat tregetare eshte ngushtesisht e lidhur ngjashmerine mes markave si dhe produkteve apo sherbimeve qe ato perfaqesojne. Mungesa e diferences se qarte mes markave mund te kushtezohet si ne rastet e markave identike qe perfaqesojne mallra apo sherbime te ngjashme, marka te ngjashme permes te cilave tregetohen produkte apo sherbime identike sikurse dhe marka e mallrat e ngjashme mes dy subjekteve.

Analiza e shkalles se konfuzionit te krijuar ne treg mes dy markave eshte derivat jo vetem i analizes se ngjashmerise se markave apo prokukteve e sherbimeve qe ato identifikojne, por dhe karakterit dallues dhe dominues te markes, fuqise terheqese te saj apo vemendjes se konsumatorit. Nje nivel i ulet i ngjashmerise mes shenjave ne kushtet e ngjashmerise se larte te mallrave e produkteve krijon konfuzion te konsumatorete, sikurse dhe anasjelltas. Marka me karakter te theksuar dallues dhe fuqi te forte terheqese ne treg krijon konfuzion te konsumatorete ne kushtet e ekzistenes se nje marke te ngjashme.

Ne rastin objekt gjykimi rezulton se markat e pales se paditese dhe produkti (oriz) qe ato identifikojne eshte i njejte, elemente te mjaftueshem per krijimin e konfuzionit ne treg mes konsumatoreve.

Ketij konstatimi i bashkangjitet dhe fakti se marka *** e pales paditese, referuar reklamimit, kohes me te hershme te rregjistrimit te saj dhe per pasoje koheshtrirjes se perdorimit ne treg ka fituar statusin e nje marke te mirenjohur dhe per pasoje fuqia terheqese e konsumatorit eshte teper e larte, cka rrit probabilitetin e veshtiresise se dallimit te saj nga marka te tjera teper te ngjashme sikurse rezulton ne rastin e te paditurit ***i sh.p.k. Provat e administruara ne gjykim, deklaratat doganore te mallit, qe datojne prej vitit 2000, konfirmojne hershmerine e tregimit te produktit oriz nen marken *** te pales paditese *** sh.p.k.

Markat *** pronesi e pales paditese gezojne karakter te theksuar dallues ne treg. Karakteri dallues i nje marke eshte e lidhur me aftesine e saj per ti mundesuar perdoruesit te zakonshem dallimin e origjines se mallrave apo sherbimeve qe ajo perfaqeson nga ato te subjekteve te tjera qe operojne ne treg. Pra funksioni esencial i markes eshte identifikimi i origjines tregtare te produktit te tregtuar.

Prezenca ne marken e pales se paditese e elementit verbal ***, qe karakterizon dhe identifikon ne menyre dalluese marken e pales paditese, shkakton dukshem konfuzion, per shkak se u sjell ne mendje konsumatoreve markat e mirenjohura te shoqerise *** sh.p.k, duke konfunduar dhe zgjedhjen prej tyre te produkteve ne treg. Duke pozicionuar si element dominues fjalen ***, ne marken ***i ***, rritet terheqja e konsumatorit ndaj produkteve te pales se paditese, ne kushtet kur elementet e tjere te markes (fjala ***i apo figura e anijes) kane natyre periferike. Perben nje konstatim te gjithepranuar se komponentet ngjyre, forme, elementet dallues verbal dhe

pershtypja e pergjithshme ne treg ndaj nje marke konsiderohen tregues te forte per perceptimin e saj nga konsumatorët.

Fjala *** konsiderohet element i forte dallues ne marken e pales paditese dhe per kete shkak ky element eshte rregjistruar si marke ne DPPM duke fituar nje nje nivel te larte dallueshmerie dhe reputacioni ne territorin e RSH per shkak te tregetimit per nje kohe te konsiderueshme te nje sere produkteve te shoqerise *** sh.p.k te tilla si fasule, sheqer, miell etj.

Tregetimi i orizit permes perdorimit ne marke te elementit te theksuar dallues *** nga pala e paditur krijon perceptimin ne radhet e konsumatoreve se malli eshte produkt i shoqerise *** sh.p.k, duke konfunduar dhe cilesite e karakteristikat e mallit te prodhuar nga pala paditese. Ne kete rast per shkak te konfuzionit te krijuar, origjina dhe cilesia e produktit oriz te pales se paditur, i atashohet produkteve te pales paditese per shkak te perceptimit te gabuar te konsumatorit. Sa me siper jo vetem qe demtohet reputacioni tregetar i pales paditese, por sigurohen ne treg perfitime te padrejta komerciale nga pala e paditur duke cenuar dhe parimet e konkurences se ndershme.

Niveli i konfuzionit mes konsumatoreve diktohet dhe nga shkalla e vemendjes se tyre per dallimin e markave ne treg dhe diferencimin e produkteve qe ato identifikojne, elemente qe jane drejteperdrejte te ndervarur nga natyra e produktit dhe menyra e tregetimit te tij. Nje nivel i ulet vemendje i ben veshtiresisht te dallueshme ndryshimet mes markave. Shpesh here konsumatorët ne treg nuk bejne krahasim te drejteperdrejte te markave, por orientojne zgjedhjen e tyre drejt markes se memorizuar me pare (imazhi joperfekt i markes).

Duke u kategorizuar ne produkte ushqimore te konsumit te gjere dhe te perditshem (oriz), nen nje kosto qe nuk cilesohet e larte nga pikepamja monetare, vemendja e konsumatorit ne perzgjedhjen e tyre ne treg eshte e ulet, cka rrit mundesine e konfundimit te markave te ndergjyqesave. Zgjedhja e konsumatorit per te tilla produkte eshte e shpejte, perqendrimi ne elementet dallues te markave i ulet dhe blerja e produktit orientohet ndaj perceptimit te meparshem vizual.

4.ekzistenca e elementeve bashkelidhes mes markave tregetare.

Ky element eshte i lidhur me origjinen tregetare te mallrave qe mbulohen nga markat. Konfuzioni mes markave shkakton perceptimin e gabuar ne radhet e konsumatorit se pronari i markes se kundershuar mund te jete dege ose distributor i pronarit te markes kundershuese, pra krijohet nje nderlidhje artificiale mes dy subjekteve tregetuese. Ne kete kontektes vertetohet dhe

bashkelidhja e markave ne gjykim. Per shkak te huazimit te elementit identifikues *** te markes se paditesit ne marken e pales se paditur konsumatorët e familjarizuar me kete element kur ndeshin ne treg produktin e markes se kontestuar, minimalisht e perceptojne me origjine tregetare nga pala paditese, duke lidhur ne menyre te gabuar dy shoqerite tregetuese. Pra transferimi identik i elementit te vetem dhe thelbesor *** i markes se pales paditese te marka e kundershuar duke i bashkangjitur dhe faktin se perfaqesojne te njejtin lloj produkti ushqimor (oriz) i mundeson produktit te markes se pales se paditur marrjen e perfitimeve te padrejta ne treg nga marka e paditesit, e cila gezon reputacion dhe mirepozicionim te hershem kohor ne treg.

Sa me siper provohet se marka e pales se paditur ***i sh.p.k eshte rregjistruar ne kundershim me ligjin “ Per pronesine industriale “ (neni 140) pasi cenon markat e meparshme *** te rregjistruara nga paditesi *** sh.p.k. Ne kushtet e konfirmimit te ekzistences se kriterëve ligjore te nenit 143 te ligjit “ Per pronesine industriale “, te siper analizuara ne vendim, te cilat percaktojne shkaqet relative te pavlefshmerise se nje marke te rregjistruar, sikurse rezulton ne rastin e shoqerise ***i sh.p.k, gjykata cmon se duhet urdheruar shfuqizimi dhe crregjistrimi nga DPPM i markes se pales se paditur ***i *** me nr rregjistrimi ***, ***, dt 22.05.2013.

Perdorimi ne treg nga pala e paditur e markes ***i *** ne kushtet e rregjistrimit te saj ne kundershim me ligjin dikton nevojën e marrjes se masave qe ndalojne perdorimin e kesaj marke dhe mosperseritjen e saj ne te ardhmen. Sa me siper detyrohet i padituri shoqeria ***i sh.p.k te ndaloje perdorimin e markes *** ne pronesi te paditesit *** sh.p.k, te ndaloje shperndarjen, tregetimin dhe reklamimin e produkteve ushqimore dhe materialeve te tjera promovuese nen marken ***i qe permban fjalen ***.

Keto masa qe garantojne zbatimin e parimeve te konkurrences se ndershme ne treg te sanksionuara ne nenet 638, 639 te KC dhe nenit 10 te Konventes se Parisit, viti 1989 “ Per mbrojtjen e pronesise industriale” synojne te mbrojne produktet kreative e intelektuale dhe investimet ekonomike te realizuara nga subjektet tregetare me qellim per te bere te dallueshme mallrat e sherbimet e tyre ne treg, te mbrojne marredheniet me konsumatorët, te inkurajoje stabilitet dhe qartesi ne marredheniet mes tyre per tu mundesuar vleresimin dhe zgjedhjen e produkteve e sherbimeve, duke perjashtuar konfuzionin mes subjekteve.

Ne rastin objekt gjykimi perdorimi nga shoqeria ***i sh.p.k i shenjave

ne marken e saj (***) qe sjellin ngaterrese me shenjen e rregjistruar me pare ne marken e pales paditese *** sh.p.k duke konfunduar perkatesine tregetare te produkteve ne radhet e konsumatoreve cenon parimet e ndershmerise profesionale dhe demton veprimtarine tregetare.

Referuar provave te administruara ne gjykim provohet se pala e paditur *** ka qene e mireinformuar ne raport me markat *** te pales paditese dhe produktin identifikues te tyre ne kushtet e ekzistences se nje bashkepunimi disa vjecar ne fushen e tregetimit te produktit oriz bazuar ne faturat tatimore te shitjes te administruara ne gjykim.

Njekohesisht pala paditese *** sh.p.k ne menyre te vazhdueshme rezulton te kete vene ne dijeni te paditurin, perpara aplikimit per rregjistrimin e markes se tij, per veprimet cenuese ne raport me markat *** te rregjistruara rregullisht me pare bazuar ne njoftimet e datave 2,13 dhe 22 maj 2013, duke renduar pasojat e tregetimit te produktit. Sa me siper konstatohet ekzistenca e keqbesimit te pales se paditur prej inicimit te procedurave administrative te rregjistrimit te markes dhe ne vijimesi ne perdorimin e saj.

Prapesimi i pales se paditur se ligjshmeria e markes se ***i *** konfirmohet dhe nga miratimi i ambalazheve te tregetimit te produkteve qe mbartin kete marke nga Drejtoria Rajonale e Autoritetit te Ushqimit Shkoder vleresohet nga gjykatai pabazuar ne kushtet kur ne kompetencen lendore te ketij organi administrative nuk perfshihet kontrolli iligjshmerise se rregjistrimin dhe me pas perdorimit ne treg te nje marke tregetare.

Persa I takon kerkimit te pales paditese per marrjen e masave per sigurimin e objektit te paditese, te specifikuara ne kerkimin e pales paditese, referuar nenit 187 te ligjit “ Per pronesine industriale “ gjykata vendos mospranimin e saj.

Mosmarreveshjet gjyqesore ne fushen e pronesise industriale per shkak te natyres specifike te tyre diktojne orientimin e vendimmarrjes gjyqesore krahas parimeve dhe instituteve te pergjithshem te se drejtes procedurale civile dhe drejt dispozitave te ligjit “ Per pronesine industriale “ i cili eshte kujdesuar qe ne kuadrin e tij procedural te disiplinoje masat e perkohshme qe duhet te merren nga gjykata per te garantuar mbrojtjen dhe ekzekutimin e ardhshem te te drejtave te cenuara te subjektit pronar te nje produkti industrial, ku perfshihet dhe marka tregetare.

Rregjistrimi i markes tregetare qe individualizon nje produkt ose sherbim perfshin ne kuadrin mbrojtjes ligjor subjektin qe gezon te drejten e perdorimit te kesaj marke (pronari imarkes) duke i siguruar mjete mbrojtese

ndaj cdo veprimi cenues ne perdorimin e markes te tij, te njejte apo te ngjashme, per te njejtin lloj produkti apo nje produkt te ngjashem,duke mbrojtur jo vetem interesat pasurore dhe jopasurore te tij, por dhe ato te konsumatoreve.

Shqyrtimi gjyqesisht ne temel i pretendimeve te pronarit te markes ne lidhje me cenimin gjate perdorimit te paautorizuar te saj nga te tretet, e shtriire ne kufijte e nevojshem procedurale kohore, mund te shkaktoje veshtiresi ne ekzekutimin ne te ardhmen te vendimit gjyqesor nese disponohet pranimi i padise, vecanerisht kur perdorimi i markes nga subjekti cenues ka karakter vazhdues.Ne kete rast cmohet e nevojshme marrja e masave qe ne thelb perbejne sigurimin e padise, me qellim ndalimin e perkohshem te veprimeve cenuese,per te parandaluar pamundesine apo veshtiresine e ekzekutimit te urdherimit perfundimtar gjyqesor ne lidhje me ndalimin e perdorimit te markes dhe eleminimin ne treg te pasojave te ardhurave nga ky veprim i paligjshem.

Aprovimi gjyqesor i zbatimit te masave te perkohshme dikton nevojen e vertetimit paraprak te gezimit te se drejtes se markes se rregjistruar konform ligjit nga subjekti pretendues, paraqitjen e provave te mjaftueshme nga te cilat krijohet dyshimi fillestar ne raport me cenimin e markes dhe situaten e paligjshmerise ne treg ne lidhje me produktin apo sherbimin e identifikuar prej saj dhe emergjencen ne marrjen e masave, moszbatimi i te cilave dote veshtiresonte ne te ardhmen rivendosjen e te drejtave te paditesit ne raport me marken e cenuar.

Marrja e masave te mesiperme eshte e kushtezuar ligjerisht (neni 187/6) me ofrimin e nje garancie te pershtatshme nga pala paditese per kompensimin e cdo demi qe mund ti shkaktohet te paditurit nga marrja e masave te perkohshme, ne rast se ne konkluzion te gjykimit cmohet i pathemelte kerkimi i pales paditese. Ofrimi i garancise, ne ndryshim nga parimet e pergjithshme procedurale civile, te cilat e cilesojne si nje vleresim te gjykates rast pas rasti, ne konfliktet e lidhura me produktet e veprimtarise industriale, perben nje kusht detyrues per zbatimin e masave, e justifikuar nga natyra e tyre dhe pasojat komerciale te ndjeshme qe mund te kene jo vetem ne raport me subjektin tregetar, por dhe me konsumatoret dhe tregun.

Paditesi *** sh.p.k megjithese argumentoi dhe provoi bindeshem perpara gjykates gezimin e te drejtes se markes *** te rregjistruar rregullisht prane DPPM dhe emergjencen ne marrjen e masave te perkohshme te parashikuara nga ligji “ Per pronesine industriale “ per ndalimin e cdo veprimi te metejsheem cenues te markes se saj nga i padituri nuk permbushi kushtin procedural te ofrimit te nje garancie per kompensimin e demeve qe mund ti shkaktoje pales se paditur. Eshte pikerisht ky fakt i vetem qe dikton vendimmarrjen gjyqesore drejt mospranimit te kerkeses per sigurimin e padise, cka orienton dhe disponimin perfundimtar gjyqesor drejt pranimit te pjesshem te kerkesepadise.

PER KETO ARSYE

Ne mbeshtetje te neneve 306 dhe 309 te KPrC, gjykata

V E N D O S I

- 1.Pranimin pjeserisht te kerkesepadise.
- 2.Shfuqizimin e markes “***i *** “ rregjistruar prane Drejtorise se Pergjithshme te Patentave dhe Markave ne pronesi te te paditurit shoqeria ***i sh.p.k, me nr rregjistrimi ***, ***, dt 22.05.2013 dhe crregjistrimin e kesaj marke nga Drejtoria e Pergjithshme e Patentave e Markave.
- 3.Detyrimin e te paditurit shoqeria ***i sh.p.k tendaloje perdorimin e markes “***” (fjale, fjale/figure) ne pronesi te paditesit *** sh.p.k, te ndaloje shperndarjen, tregetimin dhe reklamimin e produkteve ushqimore dhe materialeve te tjera promovuese nen marken “ ***i “ qe ne figure permban fjalen “***” dhe mosperseritjen e ketyre veprimeve ne te ardhmen.
- 4.Urdherohet rregjistrimi i ketij vendimi per shfuqizimin e markes “***i ***” ne rregjistrin e markave dhe publikimi i vendimit gjyqesor ne nje media te shkruar me qarkullim kombetar me shpenzimet e te paditurit.
- 5.Rrezimin e padise ne lidhje me kerkimin per sigurimin e padise.
6. Shpenzimet u ngarkohen paleve ndergjyqese ne raport me pjesen e rrezuar dhe te pranuar te padise.
7. Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane brenda 15 diteve nga e nesermja e shpalljes se vendimit. Per palen ne mungese ky afat fillon nga e nesermja e njoftimit te vendimit.

U shpall sot me dt 24.04.2017 Tirane.

**SEKRETARE
G J Y Q T A R E**

**DILA DOCI
ANTONELA PRENDI**

SHPENZIMET GJYQESORE

Takse gjyqesore 3000 leke